

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULETI I FILOLOGJISË

MA KADIRE BINAJ

**MODELET STRUKTURE TË FJALIVE  
NË GJUHËN SHQIPE**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2020

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"

FACULTY OF PHILOLOGY

MA KADIRE BINAJ

**STRUCTURAL CLAUSE PATTERNS IN  
THE ALBANIAN LANGUAGE**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2020

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA KADIRE BINAJ

**MODELET STRUKTURE TË FJALIVE  
NË GJUHËN SHQIPE**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentorja:

Prof. dr. Lindita Sejdiu Rugova

Prishtinë, 2020

## REZYME

Punimi i doktoratës “Modelet strukturore të fjalive në gjuhën shqipe” përbëhet nga gjashtë kapituj, duke përfshirë hyrjen dhe përfundimet:

Në kapitullin e HYRJES (0) trajtohet objekti, rëndësia, detyrat dhe metodat, si dhe hipotezat e studimit. Fillimisht është përkufizuar objekti i studimit, për të vazhduar më tej me argumentimin e rëndësisë së kryerjes së një studimi të tillë, me përshkrimin e metodologjisë së përdorur dhe me sqarimin e hipotezave, të cilat kanë shërbyer si pikënisje për ta bërë këtë hulumtim. Përmes këtij studimi synohet të përshkruhet e analizohet struktura e brendshme e fjalive të shqipes. Studimi është mbështetur në teorinë e valencës, sipas së cilës folja është elementi qendror i fjalisë. Për ta realizuar këtë hulumtim është bërë analizë e detajuar cilësore dhe, në raste të pakta, edhe analizë sasiore. Janë përdorur disa metoda, varësisht nga pjesë të caktuara hulumtimit. Rrjedhimisht, është përdorur metoda deskriptive, analitike, teorike, krahasimtare dhe në pak raste edhe ajo statistikore. Për t’i përshkruar e analizuar modelet e fjalive në gjuhën shqipe, është ndërtuar një korpus që përbëhet nga tekste të ndryshme. Përzgjedhja e teksteve specifike ka qenë e rastit, por përzgjedhja e grupeve të tekstit: letrar dhe joletrar dhe, deri diku, edhe e tipave të teksit, ka qenë e qëllimshme, sepse në këtë mënyrë kemi dashur të kemi një përfaqësim sa më të plotë tekstor, në mënyrë që të nxirren modelet më tipike të fjalive kanonike të shqipes (në gjuhën e shkruar e të folur).

Në kapitullin e parë është trajtuar koncepti i modeleve të fjalive në përgjithësi, për të vazhduar me studimet për modelet e fjalive në gjuhë të caktuara. Varësisht nga lloji i foljes dhe plotësit me të cilët kombinohet ajo për të formuar strukturën minimale të një fjalie, ndërtohen modele të ndryshme të fjalive në gjuhën shqipe. Një folje si *vdes*, e cila është njëvalente-

intransitive, kërkon vetëm një plotës në funksion të kryefjalës për të ndërtuar fjali. Foljet e tilla formojnë një prej modeleve të fjalive në gjuhën shqipe, modelin e fjalisë njëvalente – intransitive: Kr – folje intransitive (SV). Ndryshe nga *vdes*, folja *takoj* kërkon dy plotës për ta realizuar kuptimin e saj. Duke qenë se folja *takoj* është folje monotransitive, ajo kërkon një plotës të brendshëm në funksion të kundrinorit të drejtë dhe një plotës të jashtëm në funksion të kryefjalës. Rrjedhimisht, folja *takoj* formon një model tjetër (të kombinimit të përbërësve) të fjalisë në gjuhën shqipe, modelin e fjalive dyvalente me folje monotransitive: Kr – folje monotransitive – KD (SVO). Modelet e fjalive janë të rëndësishme edhe për përcaktimin tipologjik të gjuhëve. Sipas klasifikimit tipologjik, shqipja bën pjesë në grupin e gjuhëve SVO (kryefjalë, folje, kundrinë), njëjtë si anglishtja, frëngjishtja etj. Në shqipen ky rend mund edhe të ndryshojë, pasi që është gjuhë flektive dhe si e tillë kryesisht ka rend të lirë, mirëpo klasifikimi bëhet duke u bazuar në rendin e zakonshëm, të pamarkuar.

Kapitulli i parë ndahet në dy nënkapituj: në të parin janë trajtuar studimet për modelet e fjalive në gjuhën shqipe, ndërsa në të dytin janë trajtuar studimet për modelet e fjalive në gjuhë të tjera. Është parë se në shqipen studimet e tilla kanë qenë fare të pakta, ndërsa në anglishten e gjermanishten përshkrimi i strukturës sintaksore përmes modeleve të fjalive ka qenë mjaft i përhapur. Studimet e mëparshme, sidomos në shqipen, kanë shërbyer si pikënisje për këtë hulumtim. Ato janë analizuar e vlerësuar për kontributin e tyre, pra është bërë vlerësimi kritik i tyre dhe, duke u bazuar në të dhënat e nxjerra nga këto studime, kemi vazhduar me hulumtimin për përshkrimin dhe analizimin e strukturës së brendshme të fjalive në gjuhën shqipe.

Në kapitullin e dytë është trajtuar koncepti i valencës dhe rëndësia e saj në determinimin e strukturës së një fjalie. Një folje, varësisht nga aftësia kombinatorike e saj, mund të plotësohet me 0, 1, 2 ose 3 komplementë dhe rrjedhimisht të ndërtojnë modelet përkatëse të fjalive: modelet e

fjalive zerovalente; në të cilat folja është e vetëmjaftueshme për ta ndërtuar strukturën minimale të fjalisë; modelet e fjalive njëvalente: në të cilat folja duhet të plotësohet me një komplement, në mënyrë që ndërtojnë strukturën minimale të fjalisë, e kështu me radhë edhe për modelet e fjalive 2 e 3 valente. Është argumentuar se përveç valencës kuantitative, përkatësisht numrit të komplementëve, për strukturën e fjalisë është shumë e rëndësishme edhe valenca kualitative, pra llojet e komplementëve. Folje me numër të njëjtë të lidhjeve valencore plotësohen me komplementë të llojeve të ndryshme.

Një prej çështjeve kryesore dhe më komplekse në teorinë e valencës është dallimi ndërmjet përbërësve që funksionojnë si komplementë, nga ata që funksionojnë si adjunktë. Rredhimisht, në kapitullin e dytë janë paraqitur kriteret që shërbejnë për t'i dalluar komplementët nga adjunktët nëpër gjuhë të ndryshme, për të arritur deri te kriteret që kanë vlerë më të madhe për t'i dalluar këta përbërës në gjuhën shqipe. Është parë se asnjëri kriter nuk arrin më vetë t'i dallojë komplementët nga adjunktët, kështu që duhen kombinuar disa nga ta për ta bërë një gjë të tillë. Testi i eliminimit apo kriteri i domosdoshmërisë, kriteri i licensimit apo i lejimit, rolet semantike dhe, deri në një masë të caktuar, edhe kategoria sintagmatike rezultojnë të jenë kriteret në të cilat mund të mbështetemi për t'i dalluar komplementët nga adjunktët në gjuhën shqipe. Nga hulumtimi i bërë kemi parë se komplementët e foljeve nuk realizohen vetëm me SE, por edhe me kategori të tjera sintagmatike. Rrjedhimisht, komplementët i kemi ndarë në dy grupe: 1) në komplementë që determinohen në formë nga folja, dhe 2) komplementë që nuk determinohen në formë nga folja. Komplementët e grupit të dytë, sado që nuk determinohen në formë nga folja, janë komplementë, e jo adjunktë, sepse janë pjesë e valencës së foljes: janë elemente të domosdoshme për strukturën e fjalisë, licensohen nga një lloj i caktuar i foljes dhe janë pjesë e valencës semantike të foljes: presupozohen nga lloji semantik i foljes.

Në kapitullin e tretë është bërë klasifikimi i foljeve sipas valencës, sipas transitivitetit dhe sipas llojit semantik. Është parë se struktura e brendshme e një fjalie determinohet nga lloji i foljes, rrjedhimisht klasifikimi i foljeve ka ndihmuar në përshkrimin e strukturës së brendshme të fjalisë. Sipas valencës, foljet janë ndarë në folje 0, 1, 2, 3 e 4 valente. Klasifikimi i tillë ndihmon për sistemimin e modeleve të fjalive sipas numrit të plotësve. Më pas, foljet janë klasifikuar sipas transitivitetit: intransitive, transitive, ditransitive, intransitive-komplekse dhe transitive komplekse. Klasifikimi i tillë lehtëson përshkrimin e modeleve të fjalive sipas llojit funksional të komplementëve të brendshëm. Dhe, së fundmi, foljet janë klasifikuar edhe sipas llojit semantik. Tipi semantik i foljes determinon rolet semantike të komplementëve.

Në kapitullin e katërt janë përshkruar e analizuar modelet e fjalive të cilat janë nxjerrë nga korpusi i analizuar. Gjithashtu, në këtë kapitull është bërë edhe interpretimi i gjetjeve. Kapitulli i katërt ndahet në pesë nënkapituj: katër nënkapitujt e parë paraqesin modelet e fjalive sipas numrit të lidhjeve valencore (0-3 valente) ndërsa nënkapitulli i fundit (4.5) paraqet modelet bazike të fjalive të shqipes, të nxjerra nga rezultatet e nënkapitujve paraprakë. Nënkapitujt ndahen edhe më tej në nga tri nëndarje, sipas llojit të komplementëve me të cilët shoqërohet folja. Rrjedhimisht, 4.2 ndahet në 4.2.1 që paraqet komplementët e foljes njëvalente sipas funksionit sintaksor; në 4.2.2 që paraqet komplementët e foljes sipas kategorisë sintagmatike me të cilën realizohet komplementi dhe në 4.2.3 që paraqet komplementët e foljes njëvalente sipas rolit semantik që bartin. Më pas, në 4.2.4 jepen së bashku të gjitha llojet e modeleve të fjalive me folje njëvalente. Sipas të njëjtës strukturë janë paraqitur edhe modelet e fjalive 2 e 3 valente. Nga rezultatet e nxjerra nga hulumtimi i bërë, është parë se një komplement i një foljeje që kryen një funksion të caktuar sintaksor, mund të realizohet me disa kategori të ndryshme sintagmatike e të

bartë disa role të ndryshme semantike. Pra, një funksion sintaksor nuk presupozon (vetëm) një kategori të caktuar sintagmatike, e aq më pak një rol të caktuar semantik.

Në kapitullin e pestë jepen përfundimet e nxjerra nga rezultatet e hulumtimit.

**Fjalët kyçe:** strukturë e fjalisë, modele fjalish, valencë, komplementë, adjunktë, funksione sintaksore, kategori sintagmatike, role semantike.



## **SUMMARY**

The doctoral dissertation “Structural clause patterns in the Albanian language” consists of six chapters, including introduction and conclusions:

The chapter of INTRODUCTION (0) describes the object, significance, tasks and methods, as well as the hypotheses of the study. Firstly, the object of the study is defined, to continue with the argumentation of the significance of conducting such a study, the description of the methodology used, and the clarification of the hypotheses, which served as a starting point for conducting this research. Through this study it is intended to describe and analyze the internal structure of the Albanian clauses. The study is based on the theory of valency, according to which the verb is the central element of the clause. In order to carry out this research, a detailed qualitative analysis and, in rare cases, a quantitative analysis have been carried out. Several methods have been used, depending on different parts of the research. Consequently, descriptive, analytical, theoretical, comparative, and, in a few cases, statistical methods have been used. To describe and analyze clause patterns in the Albanian language, a corpus consisting of different texts has been built. Texts were selected randomly, but the selection of text groups: literary and non-literary and, to some extent, the selection of the text types was intentional because we wanted to have a more complete textual representation in order to derive the most typical patterns of the Albanian canonical clauses (in written and spoken language).

The first chapter discusses the concept of clause patterns in general, and continues with studies on clause patterns in specific languages. Depending on the type of verb and the complements with which it is combined to form the minimal clause structure, different clause

patterns are constructed in the Albanian language. A verb like *vdes* (“die”), which is monovalent-intransitive, requires only one complement in the function of the subject to complete the clause. Such verbs form one of the clause patterns in the Albanian language, namely the monovalent-intransitive clause pattern: S – intransitive verb (SV). Unlike *vdes* (“die”), the verb *takoj* (“meet”) requires two complements to realize its meaning. Given that the verb *takoj* (“meet”) is a monotransitive verb, it requires an internal complement in the function of the direct object and an external complement in the function of the subject. Consequently, the verb *takoj* (“meet”) forms another pattern (of the combination of constituents) of the clauses in the Albanian language, namely the bivalent clause pattern with monotransitive verbs: S – monotransitive verb – DO (SVO). Clause patterns are also important for the typological determination of languages. According to the typological classification, Albanian belongs to the SVO (subject, verb, object) language group, like English, French, etc. In Albanian such an order can change due to the fact that it is an inflected language and as such it mainly has a free order. Nevertheless, the classification is done based on the usual, unmarked order.

The first chapter is divided into two sub-chapters: the first part deals with studies on clause patterns in the Albanian language, whereas the second part deals with studies on clause patterns in other languages. It has been noted that there have been very few studies in Albanian. In English and German, on the other hand, the description of syntactic structure through clause patterns has been quite widespread. Previous studies, especially those in Albanian, served as a starting point for this research. They were analyzed and assessed for their contribution, that is, they were critically assessed and, based on the data obtained from these studies, we continued with the research of describing and analyzing the internal structure of clauses in the Albanian language.

The second chapter discusses the concept of valency and its importance in determining the structure of a clause. A verb, depending on its combinatorial abilities, can be complemented with 0, 1, 2 or 3 complements and consequently form the corresponding clause patterns: aivalent clause patterns; in which the verb is self-sufficient to form the minimal clause structure; monovalent clause patterns: in which the verb must be complemented with one complement, in order to form the minimal clause structure, and so on for bivalent and trivalent clause patterns. It has been argued that in addition to quantitative valency, namely the number of complements, qualitative valency, namely the types of complements, is also very important for the clause structure. Verbs with the same number of valency bonds are complemented with complements of different types. One of main and most complex issues in the theory of valency is the distinction between constituents that function as complements and those that function as adjuncts. Therefore, this chapter presents the criteria that serve to distinguish complements from adjuncts in different languages, concluding with the criteria that have the greatest value in distinguishing these constituents in the Albanian language. It has been found that no criteria on its own can distinguish complements from adjuncts, therefore several criteria must be combined to make such a distinction. The omission test or the criterion of obligatoriness, the criterion of licensing or permission, the semantic roles and, to a certain extent, the syntagmatic category turn out to be the criteria on which we can rely when distinguishing complements from adjuncts in the Albanian language. From the research done we have seen that verb complements are not realized only through NPs, but also through other syntagmatic categories. Consequently, we have divided complements into two groups: 1) complements that are determined in form by the verb, and 2) complements that are not determined in form by the verb. The complements of the second group, although not determined in form by the verb, are complements and not adjuncts, because they are part of the verb valency: they are

obligatory elements for the structure of the clause, they are licensed by a certain type of verb and are part of the semantic valency of the verb: presupposed by the semantic type of the verb.

In the third chapter verbs are classified according to valency, transitivity and semantic type. We have seen that the internal structure of a clause is determined by the type of verb, consequently the classification of verbs helped us describe the internal structure of the clause. According to valency, verbs have been divided into aivalent, monovalent, bivalent, trivalent and quadrivalent verbs. Such classification helped us in systematizing clause patterns according to the number of complements. Then, verbs have been classified according to transitivity: intransitive, transitive, ditransitive, complex-intransitive and complex-transitive. Such classification facilitates the description of clause patterns according to the functional type of internal complements. And, finally, verbs have also been classified according to their semantic type. The semantic type of the verb determines the semantic roles of the complements.

In the fourth chapter the clause patterns extracted from the analyzed corpus are described and analyzed. Moreover, in this chapter it is carried out the interpretation of the findings. The fourth chapter is divided into five subchapters: the first four subchapters present the clause patterns according to the number of valency bonds (0-3 valency) while the last subchapter (4.5) presents the basic Albanian clause patterns, derived from the results of the previous subchapters. Subchapters are further divided into three subdivisions, according to the type of complements with which the verb is accompanied. Consequently, 4.2 is divided into 4.2.1, which presents the complements of the monovalent verb according to the syntactic function; 4.2.2, which presents the complements of the verb according to the syntagmatic category through which the complement is realized, and 4.2.3, which presents the complements of the monovalent verb according to the semantic role that the complement carries. Then, in 4.2.4 are presented all types of clause patterns

with monovalent verbs. According to the same structure, the patterns of bivalent and trivalent clauses are also presented. Based on the results of the research we have found that a verb complement that plays a certain syntactic function can be realized through different syntagmatic categories and carry different semantic roles. Thus, a syntactic function does not presuppose (only) one syntagmatic category, and much less so a semantic role.

The fifth chapter presents the conclusions drawn from the research results.

**Keywords:** clause structure, clause patterns, valency, complements, adjuncts, syntactic functions, syntagmatic categories, semantic roles.